



INSTITUCIONET E PERKOHSHME VETEQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Vetem skice

Udhëzim Administrativ

Lënda : Pagesë shtesë për personelin e shkollave
Numer : MASHT(1) 5/2002
Date : 1 tetor 2002

Në përputhje me rregullorën nr. 2001/19 te dt. 4 tetor 2001 te degës ekzekutive te Institucioneve Kalimtare te Vetqeverisjës në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë(në tekstin e mëposhtem MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ :

Paragrafi 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi I këtij Udhëzimi Administrativ është te sqarojë marrëveshjen e pagesës”shtesë” te këtij rasti(ad hoc) te bere ne nest e MASHT-it dhe Ministrisë se Financave dhe ekonomisë(Ne tekstin e me tej MFE) ne tetor 2002.

Paragrafi 1 Shuma dhe kohëzgjatja e pagesës shtesë

- 2.1 Në bazë të marrëveshtjes se arritur mes MASHT-it dhe MFE-së I gjithë personeli I punësuar nga MASHT-I nëpër shkolla do të marr një pagesë shtesë përveq rrogës se zakonshme.
- 2.2 Pagesa maksimale do te arrijë shumën katërdhjetëkatër(44) euro ne muaj e cila do te paguhet ne përpjestimin e shpjeguar ne paragrafin e mëposhtëm nr.3.
- 2.3 Pagesa do te behet q’do muaj si pjesë e ciklit te rregullt te rrogës.

- 2.4** Gjithë personeli, siq u përshkrua më lartë ne paragrafin 2.1, që është punësuar ne mënyrë të ligjshme qe nga data 1.shtator 2002 do të ketë te drejtë në pagesën shtesë.
- 2.5** Pagesa e pare do të bëhet në tetor 2002. Kjo pagesë e kësajë shume do të vazhdojë deri me 31.dhjetor 2002. Në vitin kalendarik 2003 nuk do te ketë më pagesë shtesë.

Paragrafi 3

Ratat e pagesës

- 3.1** Arsimitarëve do tu sigurohet pagesa shtesë prej 2.20 euro për një orë mësimi, Bazuar ne numrin e orëve mësimore qe ata mbajnë, me një maksimum prej 20 orëve mësimore ne javë.
- 3.2** Shprehja “Orë mësimore” I referohet kohës kur arsimtari meson nxënësit. Në këtë kohë nuk përfshihet koha qe arsimtarët e kalojnë duke u përgatitur për orë mësimi, kur përgatisin apo vlerësojnë provimet, kur vlerësojnë hartimet apo te ngjashme pune tjera te nxënësve , kur kryejnë punë të ndryshme administrative apo qfardo pune tjetër qe nuk është ne menyre te drejtpërdrejtë e lidhur me mësimin e nxënësve.
- 3.3** Ne rast se arsimtarët kanë mëpak se 20 orë mësimi ne javë atyre do tu paguhët shtesa prej 2.20 euro vetem për orët e mbajtura mësimore.

Për pjesën tjetër te personelit

- 3.4** Gjithë personeli tjetër nepër shkolla duke përfshirë Drejtorët e shkollave, personelin administrative, rojet, pastruesit dhe të gjithë tjerët qe punojnë në shkollë me orar të plotë do të paguhën nga 44 euro sipas marrveshtjës se arritur.
- 3.5** Anëtarëve te personelit shkollor qe janë te punësuar me orar pune jo të plotë do tu paguhet pagesa shtesë konformë orëve të punës.

Paragrafi 6

10.1 Ky Udhëzim hyn në fuqi me 1 shtator 2002

Isuf Zeneli
Sekretar I Përhershëm
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë